

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Podujevës z. Agim Veliu**

I nderuari z. Veliu,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7-12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Lirim nga ngarkesat komunale për bizneset te cilat dëshmojnë se e kanë rritur numrin e të punësuarve;
- Subvencione për artizanate të vjetra që rrezikohen të shuhen;
- Hapje të punkteve shëndetësore në qendrat më të mëdha jashtë qytetit, si në Kërpimëh, Orllan dhe Lluzhan;
- Ndërtimin e një spitali tjetër në qytet;
- Për fshatin Surkish: asfaltimin e rrugës, shtrirjen e gypave të kanalizimit dhe ndërtimin e një shkolle;
- Për lagjet e pjesës Podujeva II: ndërtimin e një shkolle dhe një stacioni autobusësh;
- Rregullimin e trotuareve dhe asfaltimin e të gjitha rrugëve dhe rrugicave të qytetit;
- Gjatë dy vjetëve, e të para të qeverisjes, Podujeva do të shndërrohet në qytet evropian;
- Ngritjen e cilësisë së arsimit: kompjuterizim dhe digjitalizim te shkollave, ngritje profesionale dhe menaxheriale, autonomi për shkollat, objekte dhe hapësira më të mëdha, kujdes të veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta;
- Përkujdesje për pensionistët;
- Partneritet me subjekte afariste private;
- Zhvillim të ekonomisë dhe bujqësisë;
- Për fshatin Dumnicë e Epërme: asfaltimin e rrugës së fshatit (gjatë vitit të parë të mandatit) dhe rregullimin e urës mbi lumin e fshatit;
- Furnizim stabil me ujë të pijshëm;
- Vendosjen e një kolektori të ujërave të zeza në pjesën e qytetit të lumit Llap (brenda vitit të parë të qeverisjes);
- Vendosjen e një impianti, i cili do të bëjë pastrimin e lumit Llap nga ujërat e zeza;
- Më shumë hapësirë femrave, përmes përkrahjes së bizneseve të vogla siç janë zejet e ndryshme;
- Për fshatin Dumosh: pajisjen e fshatit me kanalizim;
- Subvencione për bujqit llapjan;
- Dhënie falas të barnave për ata që janë në kushte të rënda sociale;
- Ndërtimin e nga 10 shtëpive çdo vit për familjet skamnore të komunës;
- Asfaltimin e rrugës së Horticës;
- Për fshatin Shajkofc: ndërtimin e shkollës së re, përfundimin e kanalizimit, dhe trotuarin;

- Për fshatin Kërpimeh: një qendër të madhe të mjekësisë familjare, me laboratorë për analiza bazike dhe ordinancë stomatologjike;
- Për fshatin Tërnavë: zgjerimin e shtratit të lumit, ndërtimin e një ure për të kaluar lirshëm bujqit me makinat e tyre në arat e punës, ndërtimin e një muri mbrojtës nga rrëshqitja eventuale e dheut në oborrin e shkollës fillore të fshatit;
- Për fshatin Sfecël: ndërtimin e rrugëve të fshatit dhe kanalizimin, zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza;
- Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatin Sfecël me fshatin Sekiraqë;
- Për banorët e fshatit Obrancë: asfaltimin e rrugës Obrancë-Peran, përmirësim të infrastrukturës dhe ujësjellës;
- Për fshatin Llapashticë: asfaltimin e rrugës Llapashticë- Katunishtë dhe rinovimin e shkollës së fshatit;
- Për banorët e Shtedimit: kycjen në ujësjellës, ndërtimin e rrugës Livadicë-Dumnicë dhe rrugës Shtedim-Mirofc ;
- Për fshatin Peran: bërjen me gjithë infrastrukturën e nevojshme. kycjen në ujësjellës;
- Për fshatin Dyz dhe fshatrat tjera të asaj ane: asfaltimin e rrugëve, ujësjellës dhe kanalizime;
- Krijimin e hapësirave gjelbëruese;
- Një lokacion për stadiumin e ri të qytetit, kurse stadiumit ekzistues do t'i ndryshohet destinimi për shkak të pozitës jo të përshtatshme;
- Ndërtimin e një qendre të madhe të kulturës;
- Themelimin e një muzeu të qytetit për të ruajtur dhe konservuar gjërat e vjetra dhe të çmueshme të Llapit;
- Ndërtimin e shkollës në Metehi ;
- Ndërtimin e objekteve shkollore me qëllim të ofrimit të mësimi më cilësorë dhe gjithëpërfshirës;
- Ndërtimin i qendrave të reja të mjekësisë familjare;
- Promovimin e kulturës dhe jetës sportive për të rinjtë;
- Zhvillimin dhe modernizimin e administratës komunale me qëllim të ngritjes së nivelit të ofrimit të shërbimeve për qytetarët;
- Rregullimin e transportit urban dhe urbano – periferik;
- Rregullimin e hapësirave, parqeve dhe krijimin e oazave të reja të gjelbëruara;
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore në shërbimin civil;
- Miratimin e rregulloreve dhe harmonizimi i tyre me ligjet e miratuara;
- Ngritjen e transparencës në vendimmarrje;
- Lehtësimi i kushteve për regjistrimin e bizneseve në komunë;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)